FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.100	2004	24 dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.869, datë 22.12.2004	Për shpërblimin e personave, që përfitojnë pension.....	6739
Vendim i KM nr.888, datë 22.12.2004	Për një ndryshim në vendimin nr.185, datë 16.4.1993 të Këshillit të Ministrave "Për pagat dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve të shërbimit pyjor", të ndryshuar.....	6741
Vendim i KM nr.889, datë 22.12.2004	Për disa ndryshime në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave "Për strukturën dhe pagat e punonjësve të Policisë së Ndërtimit", të ndryshuar.....	6742
Vendim i KM nr.890, datë 22.12.2004	Për disa ndryshime në vendimin nr.56, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve të Shërbimit Informativ Kombëtar", të ndryshuar.....	6744
Vendim i KM nr.891, datë 22.12.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.54, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave "Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik dhe ushtarakëve të Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar.....	6747
Vendim i KM nr.893, datë 22.12.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", të ndryshuar.....	6751
Vendim i KM nr.894, datë 22.12.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.437, datë 3.9.1993 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të tatimeve",të ndryshuar.....	6756

VENDIM
Nr.869, datë 22.12.2004

PËR SHPËRBLIMIN E PERSONAVE, QË PËRFITOJNË PENSION

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 66, shkronja "ç", e 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 14 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004" dhe të nenit 29/1 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat, që përfitojnë pension sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përfitojnë një shpërblim të menjëhershëm, në shumën 3500 (tre mijë e pesëqind) lekë.

Këtë shpërblim e përfitojnë edhe veteranët e luftës, që nuk marrin pension, por përfitojnë vetëm nga statusi i veteranit të luftës, si dhe personat që përfitojnë pension për merita të veçanta.

2. Personat, që përfitojnë pension sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", si dhe sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përfitojnë një shpërblim të menjëhershëm, në masën 1500 (një mijë e pesëqind) lekë.

3. Përfitojnë nga ky vendim të gjithë personat, që përfshihen në pikat 1 e 2 të këtij vendimi dhe që vazhdojnë të marrin pension deri më datë 31.12.2004, përfshirë edhe këtë datë.

4. Shpërndarja e këtij shpërblimi të bëhet nëpërmjet Postës Shqiptare, sh.a.

5. Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t'i shtohet fondi prej 1 597 000 000 (një miliardë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë) lekësh, për mbulimin e shpërblimit të personave, që përfitojnë pension.

6. Ky fond të përballohet nga kursimet në fondin e personelit, të planifikuar në buxhetin e vitit 2004, miratuar për ministritë dhe institucionet qendrore, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

KURSIMET NGA FONDI I PAGAVE+SIG.SHOQERORE TE INSTITUCIONEVE BUXHETORE PER VITIN 2004

ne 000/leke

Gr	Institucionet Buxhetore	Totali
3	Keshilli Ministrave	13,000
4	Ministria Industrise dhe Energjitikes	32,000
5	Ministria Bujqesise dhe ushqimit	8,000
6	Ministria e Rregullimit Territorit dhe Turizmit	40,000
7	Ministria e Ekonomise	27,000
8	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	14,000
9	Regjistrimi i Pasurive te Paluajtshme	2,000
10	Ministria e Financave	23,000
11	Ministria e Arsimit dhe Shkences*	396,000
12	Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve	3,500
13	Ministria e Shendetesise*	587,000
14	Ministria e Drejtesise	36,500
15	Ministria e Puneve te Jashtme	18,000
16	Ministria e Rendit Publik	0
17	Ministria e Mbrojtjes	120,000
18	Sherbimi Informativ Shteteror	21,000
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	3,500
21	Drejtoria e Rezervve se Shtetit	2,000
22	Akademia e Shkences	6,500
24	Kontrolli Larte i Shtetit	2,500
25	Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale	20,000
26	Ministria e Mjedisit	4,000
27	Agjensia Kombetare e Privatizimit	5,000
28	Prokuroria e Pergjithshme	40,000
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjygjsor	30,000
30	Gjykata Kushtetuese	5,000
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	3,300
32	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	25,000
35	Drejtoria e Pergjithsme e Doganave	5,000
37	Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit	2,500
39	Drejtoria e Pergjith. e Pyjeve dhe Kullotave	28,000
41	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve	33,000
50	Instituti Statistikes	13,000
54	Enti Kombetar i Zonave te Lira	200
55	Shkolla e Magjistratures	1,000
57	Qendra Kombetare e Kinematografise	1,200
59	Instituti I Integrimit te Perndjekurve Politik	4,000
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	1,500
64	Keshilli Kombetar i RTV	0
66	Avokati i Popullit	2,000
67	Komisioni i Sherbimit Civil	0
75	Avokati i Shtetit	2,000
76	Inspektoriati i Larte Kontr. Deklarim Pasurise	12,000
77	Autoriteti I Konkurences	3,800
	TOTALI	**1,597,000**

VENDIM
Nr.888 , datë 22.12.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.185, DATË 16.4.1993 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT DHE SHTESAT MBI PAGË TË USHTARAKËVE TË SHËRBIMIT PYJOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "ç" e "dh" të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr.185, datë 16.4.1993, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Numri i klasave dhe madhësia e pagës bazë mujore, për çdo klasë, (së bashku me kompensimin e shpenzimeve nga rritja e çmimeve të bukës dhe të disa artikujve ushqimorë për vetë të punësuarin) për punonjësit ushtarakë të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe të drejtorive në varësi të saj, është përkatësisht sipas lidhjes nr.1 "Paga bazë sipas klasave për ushtarakët e shërbimit pyjor", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Niveli më i ulët i pagës (Klasa I) bëhet 10 800 (dhjetë mijë e tetëqind) lekë në muaj, ndërsa niveli më i lartë (Drejtor drejtorie rajonale/drejtor drejtorie. Klasa XXIII) bëhet 28 000 (njëzet e tetë mijë) lekë në muaj.

Punonjësve të shërbimit pyjor, që marrin pagat sipas lidhjes nr.1 të këtij vendimi, për çdo vit pune, u jepet shtesë mbi pagën bazë mujore, në masën 1 (një) për qind për çdo vit pune, por jo më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shtese të njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.

Drejtori i Departamentit të Administratës Publike dhe drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve përcaktojnë klasën përkatëse të pagës, për çdo pozicion pune, për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe punonjësit e drejtorive në varësi, sipas vendit të punës, nivelit arsimor, vështirësisë në detyrë dhe rrethanave të tjera të kësaj natyre.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2004, të përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për këtë vit, për paga e sigurime shoqërore, për Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA NR.1

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT USHTARAKE TË SHËRBIMIT PYJOR

Nr.rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	i	10800
2	II	11000
3	III	11300
4	IV	11600
5	V	12000
6	VI	12300
7	VII	12600
8	VIII	12900
9	IX	13100
10	X	13900
11	XI	14400
12	XII	14800
13	XIII	15500
14	XIV	16000
15	XV	16300
16	XVI	16700
17	XVII	17000
18	XVIII	18000
19	XIX	19000
20	XX	20000
21	XXI	22000
22	XXII	24000
23	XXIII	28000

VENDIM
Nr.889, datë 22.12.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.440, DATË 9.9.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR STRUKTURËN DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË NDËRTIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "ç" dhe "dh" të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, date 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar të bëhen këto ndryshime:

a) Tabelat nr.2 "Pasqyra e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit në qendër" dhe "Pasqyra e pagave për punonjësit e degëve të Policisë së Ndërtimit në rrethe"

zëvendësohen me tabelat me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

b) Niveli më i ulët i pagës (Klasa I), për punonjësit e Policisë së Ndërtimit, bëhet 10 800 (dhjetë mijë e tetëqind) lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (Kryetar dege / Klasa XXII) bëhet 28 000 (njëzet e tetë mijë) lekë në muaj.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2004, të përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për këtë vit, për paga e sigurime shoqërore, për Policinë e Ndërtimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Tabela Nr. 2

PASQYRA E PAGAVE PER PUNONJESIT E DREJTORISE SE POLICISE SE NDERTIMIT NE QENDER

Nr.	EMERTIMI	KLASA	PAGA NE LEKE
1.	Drejtor		74345
2.	Zevendesdrejtor		55422
3.	Kryetar Dege	XXII	28000
4.	Shef Sektori	XXII	28000
5.	Kryetar Grupi Gadishmerie	XXII	28000
6.	Specialiste	XXI	26000
7.	Shofer	IX	15800
8.	Punonjes Grupi Gadishmerie	XIX	21800
9.	Arkivist. Dkatilografist. Protokollist	VI	13900
10.	Magazinier	VI	13900
11.	Sekretare, daktilografiste.	VI	13900
12.	Punonjes Sherbimi	III	12500
13.	Pastruese	I	10800

Tabela Nr. 2

PASQYRA E PAGAVE PER PUNONJESIT E DREJTORISE SE POLICISE SE NDERTIMIT NE RRETHE

Nr.	EMERTIMI	KLASA	PAGA NE LEKE
1.	Kryetar Dege K1	XXII	28000
2.	Kryetar Dege K2	XXI	26000
3.	Shef Sektori	XXI	26000
4.	Specialist i larte	XX	23500
5.	Specialsit i mesem	VIII	14500
6.	Kryetar Grupi Gadishmerie	XXI	26000
7.	Specialist Grupi Gadishmerie	XIX	21800
8.	Arkivist - Protokollist	VI	13900
9.	Shofer	IX	15800

VENDIM
Nr.890, datë 22.12.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.56, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE TË SHËRBIMIT INFORMATIV KOMBËTAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "ç" e "dh" të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.56, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë i pikës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Numri i klasave dhe madhësia e pagës bazë mujore, për çdo klasë (së bashku me kompensimin e shpenzimeve nga rritja e çmimeve të bukës dhe të disa artikujve ushqimorë për vetë të punësuarin), për punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, janë përkatësisht sipas Lidhjes nr.1, "Paga bazë sipas klasave për punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Niveli më i ulët i pagës (Klasa I) bëhet 10 800 (dhjetë mijë e tetëqind) lekë në muaj, ndërsa niveli më i lartë (Drejtor drejtorie në bazë, zëvendësdrejtor drejtorie në aparatin qendror dhe në Drejtorinë e Tiranës, Klasa XII), bëhet 38 500 (tridhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë në muaj.".

b) Paragrafi i dytë i pikës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Drejtori i Departamentit të Administratës Publike dhe drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit përcaktojnë klasën përkatëse të pagës, për çdo pozicion pune, për punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, në varësi të vendit të punës, nivelit arsimor, vështirësisë në detyrë dhe rrethanave të tjera të kësaj natyre.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2004, të përballohen nga fondet e miratuara për këtë vit, për paga e sigurime shoqërore, për Shërbimin Informativ të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA Nr.1

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE PER PUNONJESIT E SHERBIMIT INFORMATIV TE SHTETIT

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	10800
2.	II	11000
3.	III	11300
4.	IV	11500
5.	V	11700
6.	VI	12000
7.	VII	12500
8.	VIII	12900
9.	IX	13400
10.	X	13900
11.	XI	14500
12.	XII	15100
13.	XIII	15900
14.	XIV	17000
15.	XV	19000
16.	XVI	20000
17.	XVII	21500
18.	XVIII	24000
19.	XIX	27000
20.	XX	30000
21.	XXI	33500
22.	XXII	38500

VENDIM
Nr.891, datë 22.12.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.54, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SISTEMIN E PAGAVE TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK DHE USHTARAKËVE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "ç" e "dh" të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.54, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Titulli i vendimit zëvendësohet me:

"PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE TË SISTEMIT TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK, TË SISTEMIT TË MINISTRISË SË DREJTËSISË DHE TË SISTEMIT TË MINISTRISË SË PUSHTETIT VENDOR DHE TË DECENTRALIZIMIT".

b) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Numri i klasave dhe madhësia e pagës bazë mujore, për çdo klasë (së bashku me kompensimin e shpenzimeve nga rritja e çmimeve të bukës dhe të disa artikujve ushqimorë për vetë të punësuarin) për ushtarakët e Gardës së Republikës, janë, përkatësisht, sipas Lidhjes nr.1, "Paga bazë sipas klasave për ushtarakët e Gardës së Republikës", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Numri i klasave dhe madhësia e pagës bazë mujore, për çdo klasë (së bashku me kompensimin e shpenzimeve nga rritja e çmimeve të bukës dhe të disa artikujve ushqimorë për vetë të punësuarin) për ushtarakët e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, janë, përkatësisht, sipas Lidhjes nr.2, "Paga bazë sipas klasave për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Numri i klasave dhe madhësia e pagës bazë mujore, për çdo klasë (së bashku me kompensimin e shpenzimeve nga rritja e çmimeve të bukës dhe të disa artikujve ushqimorë për vetë të punësuarin) për ushtarakët e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, janë, përkatësisht, sipas Lidhjes nr.3 "Paga bazë sipas klasave për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kompensimi, për vetë atë dhe për personat në ngarkim, që ka përfituar çdo ushtarak, bashkohet me pagën bazë mujore.".

c). Pas pikës 1, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

"1.1 Ministri i Rendit Publik dhe drejtori i Departamentit të Administratës Publike të përcaktojnë klasën përkatëse të pagës, për çdo pozicion pune, për ushtarakët e Gardës së Republikës, në varësi nga vendi i punës, niveli arsimor, vështirësia në detyrë dhe rrethana të tjera të kësaj natyre.

Ministri i Drejtësisë dhe drejtori i Departamentit të Administratës Publike të përcaktojnë klasën përkatëse të pagës, për çdo pozicion pune, për ushtarakët e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të institucioneve të riedukimit dhe burgjeve, në varësi të saj, sipas vendit të punës, nivelit arsimor, vështirësisë në detyrë dhe rrethanave të tjera të kësaj natyre.".

ç) Pas pikës 2, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

"2.1 Ushtarakëve të Gardës së Republikës, të Policisë së Burgjeve dhe të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, që marrin paga sipas Lidhjeve nr.1, nr.2 dhe nr.3 të këtij vendimi, u jepet shtesë mbi pagën bazë mujore, në masën 1 (një) për qind, për çdo vit pune, por jo

më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shtese të njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2004, të përballohen nga fondet e miratuara për këtë vit, për paga e sigurime shoqërore, përkatësisht, për Gardën e Republikës, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA Nr.1

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE PER PUNONJESIT USHTARAKE TE GARDES SE REPUBLIKES

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	10800
2.	II	11000
3.	III	11200
4.	IV	11400
5.	V	11700
6.	VI	11950
7.	VII	12700
8.	VIII	13300
9.	IX	14000
10.	X	15300
11.	XI	15750
12.	XII	16200
13.	XIII	17700
14.	XIV	18500
15.	XV	19300
16.	XVI	20000
17.	XVII	20850
18.	XVIII	23300
19.	XIX	25650
20.	XX	28900
21.	XXI	32150
22.	XXII	40600

LIDHJA Nr.2

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE PER PUNONJESIT USHTARAKE TE POLICISE SE BURGJEVE

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	10800
2.	II	11000
3.	III	11300
4.	IV	11600
5.	V	12000
6.	VI	12300
7.	VII	12600
8.	VIII	12900
9.	IX	13100
10.	X	13500
11.	XI	13900
12.	XII	14200
13.	XIII	14600
14.	XIV	15000
15.	XV	15500
16.	XVI	16000
17.	XVII	17000
18.	XVIII	19000
19.	XIX	21500
20.	XX	24000
21.	XXI	28000
22.	XXII	38000

LIDHJA Nr.3

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE PER PUNONJESIT USHTARAKE TE POLICISE SE MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPETIMIT

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1.	I	10800
2.	II	11000
3.	III	11200
4.	IV	11400
5.	V	11700
6.	VI	11950
7.	VII	12700
8.	VIII	13300
9.	IX	14000
10.	X	15300
11.	XI	15750
12.	XII	16200
13.	XIII	17700
14.	XIV	18500
15.	XV	19300
16.	XVI	20000
17.	XVII	20850
18.	XVIII	23300
19.	XIX	25650
20.	XX	28900
21.	XXI	32150
22.	XXII	40600

VENDIM
Nr.893, datë 22.12.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "ç" e "dh", të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.11.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në paragrafin e parë të pikës 7, pas fjalës "…punonjësve…"

shtohen "…të institucioneve buxhetore…".

b) Lidhja II "Paga bazë sipas klasave", Lidhja II/1 "Paga bazë sipas klasave për punonjësit e shëndetësisë" dhe Lidhja II/M "Paga bazë për punonjësit e ministrive, të institucioneve të tjera qendrore, ATSH-së, prefekturave dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar", zëvendësohen me lidhjet, me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

c) Në klasifikimin B5 të Lidhjes I "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit", shtohen këto emërtesa:

"Zëvendësdrejtor në Bibliotekën Kombëtare",

"Zëvendësdrejtor në Institutin e Monumenteve të Kulturës".

ç) Lidhja II-18 "Niveli i pagave për punonjësit e këshillave të rretheve e bashkive", zëvendësohet me Lidhjen II-18 "Niveli i pagave për punonjësit e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i shkronjave "b" e "c" të pikës 1 të këtij vendimi, për vitin 2004, të përballohen nga fondet e miratuara për këtë vit për paga e sigurime shoqërore, për institucionet buxhetore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe për punonjësit që përfitojnë rritje page, sipas shkronjës "b" të këtij vendimi, efektet financiare fillojnë nga data 1 korrik 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA II

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	10800
2	II	11000
3	III	11300
4	IV	11600
5	V	11900
6	VI	12400
7	VII	12800
8	VIII	13300
9	IX	13800
10	X	14000
11	XI	14500
12	XII	15500
13	XIII	18500
14	XIV	23000

LIDHJA II/1

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE PER PUNONJESIT E SHENDETESISE

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	10800
2	II	11000
3	III	11300
4	IV	11600
5	V	11900
6	VI	12000
7	VII	12500
8	VIII	12900
9	IX	13500
10	X	14000
11	XI	14500
12	XII	16000
13	XIII	19000
14	XIV	23000

LIDHJA II/M

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE PER PUNONJESIT E MINISTRIVE, INSTITUCIONEVE TE TJERA QENDRORE, ATSH, PREFEKTURAVE DHE SHERBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	10800
2	II	11300
3	III	11800
4	IV	12400
5	V	13500
6	VI	14500
7	VII	16500
8	VIII	19000
9	IX	21000
10	X	25500

NIVELI I PAGES PER PUNONJESIT E DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE SHERBIMIT TE PERMBARIMIT GJYQESOR

I.

Nr.	EMERTIMI	KLASIFIKIMI
1.	Drejtor i pergjithshem.	A12
2.	Zevendesdrejtor i pergjithshem.	B3
3.	Pergjegjes i sektorit te inspektimit.	B5
4.	Inspektor i permbarimit gjyqesor.	B5
5.	Kryetar i zyres se Permbarimit.	B5
6.	Permbarues. Psikolog.	C2

II.

Nr.	EMERTIMI	KLASA	SHTESE PER FUNKSION
1.	Pergjegjes sektori ne drejtorine e pergjithshme.	IX	5
2.	Pergjegjes sektori ne zyrat permbarimore.	IX	3
3.	Specialist ne drejtorine e pergjithshme e ne zyrat permbarimore.	VIII	

Shenim: Per punonjesit e tjere, zbatohet Lidhja II-5 "Niveli i pagave per punonjesit e ministrive dhe institucioneve te tjera qendrore", te ketij vendimi.

VENDIM
Nr.894, datë 22.12.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.437, DATË 3.9.1993 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË TATIMEVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "ç" e "dh" të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.437, datë 3.9.1993 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë vijon:

"Numri i klasave dhe madhësia e pagës bazë mujore, për çdo klasë (së bashku me kompensimin e shpenzimeve nga rritja e çmimeve të bukës dhe të disa artikujve ushqimorë për vetë të punësuarin) për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të degëve në varësi të saj, janë përkatësisht sipas Lidhjes nr.1 "Paga bazë sipas klasave për punonjësit tatimorë", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

b) Pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi më këtë përmbajtje:

"Punonjësve tatimorë, që marrin paga sipas Lidhjes nr.1 të këtij vendimi, u jepet shtesë mbi pagën bazë mujore, në masën 1 (një) për qind, për çdo vit pune, por jo më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shtese të njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.".

c) Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë vijon:

"Drejtori i Departamentit të Administratës Publike dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të përcaktojnë klasën përkatëse të pagës, për çdo pozicion pune, për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe punonjësit tatimorë të degëve në varësi të saj, sipas vendit të punës, nivelit arsimor, vështirësisë në detyrë dhe rrethanave të tjera të kësaj natyre.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2004, të përballohen nga fondet buxhetore për këtë vit për paga e sigurime shoqërore, të miratuara për Drejtorinë e Përgjithshme të tatimeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA NR.1

PAGA BAZE SIPAS KLASAVE PER PUNONJESIT TATIMORE

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	10800
2	II	11750
3	III	12300
4	IV	12700
5	V	13100
6	VI	13900
7	VII	14200
8	VIII	14500
9	IX	15600
10	X	17100
11	XI	17800
12	XII	18300
13	XIII	19100
14	XIV	19700
15	XV	20200
16	XVI	20700
17	XVII	21000
18	XVIII	21500
19	XIX	21800
20	XX	23500
21	XXI	26000
22	XII	28000

Fletorja Zyrtare gjendet:
Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	**1500**
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	**2000**

Doli nga shtypi më 24.12.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë